


Zemra e di



*Për ty vashë shqiptare që vëllon ta njollosën...
Për Ty dhe baballarët, që tradhtia I coi në zemërplasje e lotët e
bijave ua lëkundën edhe eshtrat ndër varre!*

Fjala e redaktorit:

Kuptime shenjtëruese e hyjnizuese për tri besnikëri apo tri dashuri I gjejmë pikërisht në vëllimin me poezi me titull "Zemra e di" të poeteshës së re (në moshë) por jo edhe në pjekuri të krijimeve, të z. Ajete Beqirajt. Në këtë mare sacrum (det të shenjtë) të kësaj poetesheje bëhen të pavdekshme deri në hyjnizim dashuria në kuptimin e thellë të një ëndrre të pastërt si burimi malit, për një djalosh, më pastaj ajo e vendlindjes, sepse autoren si duket valët e jetës e hedhin edhe nëpër botë, e në këtë edhe një dashuri skofiare atërore, që zgjohet vetëm nga një zemër e pastër, që di, që ndjen dhe që tkurret për t'et.

Kur Zemra e Di, edhe metafora e saj e di se ka për detyrë të qëmtojë varg të ri, të lirë, të figurshëm dhe të prirur nga butësia njërëzore. E shtyë nga forca e brendshme për të thënë atë që di zemra, autorja Ajete Beqiraj ka hapur një prolog dhe brenda një universi poetik ka futur gjithë ëndërrimet e saja për të thënë gjëra të pathëna apo motivet jetësore për t'I shprehur në një mënyrë tjetër, vazhdimisht dhe në një rrjedhë të pasosur për t'I shkrirë në kredon krijuese. Që nga hapja e gjer në mbyllje të librit sikur ndodh një tërmet shkundullues në shpirtin e saj, sepse ajo brenda është vetëvetja e autores, ku shpreh individualitetin njerëzor e qytetar në trajtën e vet, që deri në këtë process e con gjëndja e trazuar shpirtore.

Kujtimet e përfytyrimet e saj lidhur me vende,

situata e njerëz të dashur, marrin një trajtë të gjallë dhe u blatohej këtyre ndjenjave në mënyrë origjinale, me një zë të vetin e tingëllimë të përpiktë, më përjetim personal po edhe universal.

Meritë e A-Jetës është se ajo di të mbrujë poezinë apo ëndrrën e vet me jetën e psikologjinë në kohë dhe në hapësirë të caktuar. Te kjo vërtetësi e con frymëzimi, lënda shpirtërore e cila pa u thënë kështu nuk bën se E di Zemra ose Zemra e Di, që është e shqetësuar, sic është e shqetësuar poezia e saj që mëton të jetë larg cdo imitimi formal.

Kriteret e përzgjedhjes për botim të poezive qenë në shije të autores po dhe të redaktorit e të recenzuesit, që iu nënshtruan asaj që na e preku shpirtin, asaj që na u imponua me vlerat që bart.

ZEJNULLAH HALILI

Adhurim

*Ti je muzgu je agimi
Loti im dhe buzëqeshja
Ti je trupi edhe shpirti
Lindja ime edhe vdekja
Ti je plaga dhe shërimi
Je dashuria dhe mjerimi
Ti je sprova dhe shpëtimi
Je gjithë bota dhe amshimi*

*Të falem o Zot
Për jetën që më fale
Për shpirtin e ciltër
Ardhmërinë që më prët
Për trupin e pastër
Zemrën e kulluar
Mu në thelbin e saj
Drita Jote e Shenjt*

Agim I rinisë

*Kur bari loz me rrezet e diellit
Dal në bashqen e bleruar
Lulet e bukura ma zgjasin jetën
Me aromën e tyre të kulluar*

*Kur ulem në barin e butë
Në duar më pushojnë fluturat
Mes qilimit të gjelbër zë vend
Dhe ua shikoj krahët e bukur*

*Kur mbi fshatin e fjetur
Nata pranverore mbretëron
Kur si nëna fëmijët
Hëna yjet pranë vetes fton
Nën llambën e ndezur me një rreze ylli
Trupi im pushon
Këngë e xhinkallave serenatë më bëhet
E gjumi qepallat m'I rëndon*

*Kur agimi I bardhë
Ditën e re lajmëron
Dashuria për jetën zgjohet
Më parë se të zgjohem unë
2 qershor '88*

Baladë mërgimi

Pa pandehur

*Kur nga trupi I nënës
Si vesa nga lulja pikëva
Në ty toka ime
Hapin e parë hodha*

*Kur në prehërin e babait
Si bleta në polen pushova
Krodhen e parë të bukës
Nga dheu yt shijova*

*Ditët e jetës sime
Në ty më lindën e më rritën
Por fare pa pandehur
Ato dhe unë të braktisëm*

Largim

*Kot ditë e natë
End pëlhurën e shpresës
Koha me vite baba
Mes nesh po ngrit një mur
As qilimat e ëndrrave
Atlas të koshaisur
Atje ku je Ti
S'do t'më shpien kurrë*

*Nga mërgimi I largët
Unë prapë të tund shaminë
Në një orë të bekuar
Ne do të takohemi
Mirupafshim baba
Atje ku u ndamë
Kurrë më mos u ndafshim
Kur serish të bashkohemi*

30 gusht '95

Trëndafil në mërgim

*Moj erë e ngrohtë vere
Që petalet m'I përqedhel si mëma ime dikur
Mos u mundo t'ma kthesh freskinë
Rrënjët në këtë tokë S'do t'më ngjiten kurrë*

*Braktisa kopshtin tim në agimin e jetës
Për kurorën time kërkova diell më t'nxeh të
Por gjethet e mia përvëlojnë lotët
Që në dheun tim më binin sikur vesë*

*Barra e rëndë e mallit që më kërrus shtatin
Që çdo orë të ikur më rëndon si gur
Kot vëshkëm e tretëm se edhe kur të kthehem
Vendin tim të vjetër s'do ta gjej më kurrë*

Ngrohtësi Kosove

*Këndo bilbil
Edhe në dhe të huaj
Me atë zë të ëmbël
Që në atdhe dëgjova
Këndo ashtu ëmbël
Sic këndove atje
Se edhe gjuhën tënde
Në mërgim mësova*

*Më këndo bilbil
Me gjuhën e mallit
Se vec gjuhës së mëmës
S'desha gjuhë tjetër
M'vajto pranverat
Që lashë në Kosovë
Shpirti do të ndjej serish
Ngrohtësinë e vjetër*

Lakmi

*Shkruaj për ty shpend shtegtar
Që sa herë të ftohtët të mbërthen
Me krahë të lehta pushton qiellin
Në vise të ngrohta shkon e zë vend*

*Të kam lakmi ty shpend fatlum
Që vec ndër rreze flatrat shkëlqen
Më së tepërmi kur në pranverë
I lirë kthehesh në vendin tënd*

*Lum si ti shpend pendshkruar
Që panda verë përtërin
Mjerë si unë e mërguar
Që u robërova larg vendit tim*

Vjeshtë

*Në një cast të harruar
Në një orë të mallkuar
Krahëthyer u nisa të gjej
Pranverën e vonuar
Dhe hyra në vjeshtën
Kurrë të pambaruar*

Psherëtimë

*Kur një shikim si meteor
Nga drita e syve të tu
U shkëput
Me shkëlqimin e yllit
Ndricoi
Rrugën e fatit tim
Zemra dashurisë I pohoi
Ti je Ai
Që gjithë rininë prita*

*Kur në zemrën e përgjysmuar
Bashkëve Gjysmën tënde
Shpirti heshtur psherëtiu
Rri përjetsisht pranë meje
Unë pas teje mallkoj dashurinë*

Vetëm Ti

*Dashuri është ajo
Kur mes gjithë njerëzve
Të shoh vetëm Ty
Dashuri është ajo
Kur dy palë buzë
Bashkohen në një*

*Ti për mua je Ai
Unë për Ty jam Ajo
Jemi dy copëza zemre
Se të dua dhe me do*

Vetmi

*Ëndrra ime vajzërore
Me kujtimin tek unë vjen
Dhe si ylli që del në natë
Edhe ti mes saj shkëlqen
Fjollat e borës plot bardhësi
Më thurrin një kurorë të kristaltë
Një erë e hollë dimri
Më sjell aromën e trupit tënd*

*Nata perden e saj të rëndë
Më ngadalë kur e ngreh zvarrë
Siç ua merr yjeve shkëlqimin
Agimi ëndrrën ma grabit
Buzët e etura vetëm për ty
Psherëtinë e pëshpërisin
Dashuri unë të pres
Eja të lutem përsëri*

Pritje

*Nëse shumë kohë
Më duhet të të pres
Petkun do ta qep
Me kujtimin për Ty
Edhe ti do ta ndjesh
Barrën e pritjes sime
Kur pajën ta qendis
Me lotët e syve të mi*

*Cdo natë me ty
Në ëndrra do të fle
Dashurinë do ta mbjell
Trëndafile në shpirtin tim
Me kurorat e purpurta
Do të erëmoj trupin
Me petalet e vesuara
Do të lahem cdo agim*

Agimet e arta

Sonte

*Mendimet e heshtura
Fshehurazi do t'I kuptoj
Fjalët e pathëna
Në buzë do të t'I lexoj
Visaret në krahëror
Natën do të t'I gjej
Pëshpëritjet e shpirtit
Heshtur do t'I ndjej*

*Kur të shuash zjarrin
Kur të hapësh zemrën
Psherëtimat do t'më rrëfejnë
Në më do vërtet*

Ylli I Fatit

*Kur heshtjen e dashurisë
Trazonin psherëtimat
Pranë buzëve ndjeja
Frymën tënde
Shpirti Im I dehur
Fluturonte mbi re
Zemra gjënte veten
Mes mjegullës së jetës*

*Kur dielli I ditës së re
Derdhi rrezet mbi ne
Agimin e jetës
Me emrin tënd thirra
Ty të emërova
Ylli I Fatit tim
29 tetor '96*

Premtim

*Sa shikime hodhe mbi mua
Aq yje qielli do të mbledh
Sa herë trupin tënd më fale
Shpirtin do të ta fal poaq herë*

*Sa herë zemrën të qëllova
Do të të dashuroj në aq mënyra
Në një shekull të vetëm kohe
Do të të dua sa njëmijë zemra*

Agimet e arta

*Sikur dielli në mes të dimrit
Sikur rrezja e tij në borë
Si gëzimi mes mjerimit
Dora jote më bie mbi dorë*

*Si takimi mes përmallimit
Sikur uji mbi faqet e djegura
Puthjet e tua më binë në buzë
Si në petale kur pushon vesa*

*Sikur engjëlli nën flatrat e buta
Fshihesh nën flokët e mi të gjatë
Sikur ylli mes qiellit të kthjellët
Sytë e tu shkëlqejnë në natë*

*Netët e mbushura përçafime
Puthjet e gjata që trupin dehin
Edhe diellit ia shuajnë zjarrin
Agimit të artë dritë ia zbehin*

Aty ku fillon jeta

*Nëse ne të dy
Ndahemi ndonjëherë
Në buzë përjetësisht
Do të fle buzëeqeshja e vrarë
Qielli s'do t'iu ngjasë më
Syve të tu të kaltër
Dielli do të verbohet
Që në agimin e parë*

*Se Ti hyre atje
Ku fillon Jeta
Dhe aty do të mbetesh
Edhe kur Ajo të shuhet
Qënja ime pa Ty
Do të jetë mallkim fati
Bredhja ime si hije
Jetë me s'do të quhet*

Pa gjumë

*Sonte gjumi m'ka braktisë
Mos e mbyll qepallën e gjatë
Hapi sytë e kaltër det
Do të zhytem në ta guacë*

*Këndellu dhe më shiko gjatë
Ashtu sic di vetëm Ti
Kokrra margaritarësh
Do t'më shkëlqejnë në gjinj*

*Vetëm kur jemi bashkë
Shpirti im gjen qetësinë
Zemra vetëm nga buzët e tua
Pranon dhëmbjen e dashurinë*

Ftesë

*Kur qiellin tënd braktisin yjet
Mos shiko retë e errëta
Por pusho në gjirin tim
Aty do t'gjesh një botë tjetër
Përplot rreze drite
Ajo do të të ndihmoj
Aq sa t'I bësh lak
Edhe një thyerje zemre*

*Pusho në gjirin tim
Kjo është ftesë
Nëse ke besë*

Nektar helmi

*Kupa e zemrës sime
Vetëm nga sytë e tu
Mbushet edhe zbrazet
Nektari dhe helmi
Nga buzët e tua trazohen
Kur shkrihem bashkë
Në ndjenja që përvëlojnë
Zemra ma thotë
Edhe mes dhëmbjes
Dashuria krijohet*

*Të pres pse jam jotja
Kur më jepesh të falem
Ngaqë të dua më duhesh
Hapat të cojnë larg meje
Por ngado që të shkoh
Në qerdhen e zemrës ruhesh*

Ofshamë e trazuar

Lumturia dremit

*Pema e jetës sime
S'farfurit më hareshëm
Pranë burimit të rinisë
Që ngadalë po shterron
Qielli I fatit tim
Nuk pikon më shpresë
Të zgjojë lumturinë
Që në t'kaluarën dremit*

Lule e venitur

*Lulja me aromë joshëse
Derdh petalet për tokë
Shpresa e mirë
Ngadalë po më braktis
Kënga zëvogël e fatit
Gjithnjë e më larg dëgjohet*

Tani e di

*Me lulet më të bukura
Thura shpresat për ne
Në ëndrrat e rinisë
Shtegtova gjatë me ty
Përse fati më përqeshte
Vetëm tani e di*

Maskotë

*Kot quajte qytetin tonë
Fole e dashurive fatlume
Unë tani e di
Por ti edhe atëherë e die
Se po mashtroje
Veten edhe mua
Maskotë e bukur*

Këngë e ndrydhur

Pagëzim

*Ti I Vetmi qe mundesh
T'më gëzosh prehërin
Ti I Madhërishëm që do
T'me pagëzosh me emrin
Nënë
Më fal një qupë si hënë
Apo një djalë si diellin
Vetëm me fatin tim
Të lutem mos ma fal*

*Ti e Di o Zot
Ti me Sheh o Zot...*

24 shkurt '97

Parandjenjë

*Dicka e mistershme
Sonte ma mundon trupin
Dicka e pakuptueshme
Si pëshpëritja e vdekjes*

*Diçka e ftohtë akull
Ma bën zemrën varr
Gjithë nusëria ime
Dhëmbje plagë vrragë*

Në parzmë

*Asnjë yll s'më pushpi në parzmë
Djepin për foshnjën e parë
Nëna ma ruajti qot
Ngela prehërbrazët
I rrejshëm ishte ai gëzim
Si e gjithë kjo botë*

Muri i ëndërrave

*Muri I ëndrrave
Leskërohet
Llamba e shpresës
Zbehët
Vesa e gezimit
Përjetësisht avullohet
Në trupin tim
Varr të gjallë mbi tokë*

27 shkurt '97, Dillingen a.d.Donau

Shpresëfikur

Ofshamë e trazuar

*Ulberi shtrihet në qiell
Serish në pranverë
Engjëjt e bukur në shi
Lajmë flatrat e bardha
Por unë s'e dua shiun
Siç e desha dikur
Kur si vashë e lumtur
Lagja flokët e gjata*

*Se me kohë në jetën tënde
Jam vetëm një grua
Unazë në gishtin tënd
Që s'më heq as s'më vë
Mes mureve të ftohta
Ofshamë e trazuar heshtur
Në shtratin e zbrazët
Vajtim I pa zë.*

Dielli im

*Ti më detyron
Ditet t'I pres ditët pa ty
Drita e diellit shuhet
Zemra ka braktis lumturinë*

*Ti më detyron
Netët t'ia fal netët vetmisë
Mengjesi për mua nuk agon
Drita e tij shuhet në sytë e mi*

*Dielli im më ngroh
Unë po ngrij nga ftohtësi e jetës
Dashuri me mbaj në gjë
Unë po tretem nga vetmia e madhe
Lumturi kthehu tek unë
Unë po vdes nga therrja e plagëve*

Mallkim

*Kush po të vjedh nga krahët e mi
Vallë kush zemrës m'I vë thikën
Dashuria jonë përse s'frymon më
Lulja e shpresës më thuaj pse vyshket*

*Përse braktis krahërorin tim
Ndarjen tonë vallë kush po e sjell
Zot I Madh mallkoje atë
Që fatin e huaj vjedh*

Pa titull

*Kush të gënjeu
Se dashuri e falur merret
Kush të mësoi kaç kaç
Të më qëllësh zemrën
Cila të mashtroi
Cila të vrau shpirtin
Më lejo të lus Zotin
Për ty e për unë*

Më kupto

*Kupto të lutem zemrën time
Që thellë në gji të shtrëngon
Kupto syrin tim të fikur
Që lotin për ne nuk ndalon
Kupto trupin e këputur
Që po dergjjet nga largësia jonë*

*Më kupto dhe më ndihmo
Dhëmbja shpirtin panda mundon*

Shpresëfikur

*Ti ik nga unë
Këmbëlehtë si era
Mu si një engjëll
Që s'mund ta dashuroj
Se unë I dashuri im
Do të pres gjuhën
Më parë se të të mallkoj*

*Do të pushoj edhe më tutje
Në renë e jetës ëndërrueshëm
Shpresëfikur do të ëndërroj
Një diell të amshueshëm*

Guacë e vetmisë

*Nuse fatkeqe jam
Veshur në pikëllim
Zhytur në dhëmbje
Preshje të trupit kam
Guacën e vetmisë
Botën time të vetme*

Dhe iqe

*Celësin e asaj porte
Ty ta pata besuar*

*E Ti
Zemrën time grabite
Dhe iqe*

Kthehu

*Luginë e dashurisë
Ende është e gjelbër
Kthehu sa s'është vyshkur
Nga lotët e largimit
Kthehu
Për lumturi
Kurrë s'është vonë
Mos më fal
Kaq shpejt harrimit*

*Eja të mbledhim bashkë
Vesën mëngjesore
Ta ujisim Trëndafilin e Dashurisë
Eja pranë meje
Zjarri i zemrave do të ndez
Qiriun e ardhmërisë*

*Kthehu
Se largimi është dënim
Se ndarja është mallkim*

Zemër e përgjakur

*Nuk besoja se dashuria është flakë
Gjersa vet s'u bëra prush
Se shigjetë e saj të përgjak
Gjersa një pellg në zemër s'u mbush*

*Mes netëve të kërkoj në shtrat
Por nuk të gjej më pranë vetes
Duart e mia mbesin të zbraza
Unë mbyll sytë para vet jetës*

*Mëngjeseve që vinë pa ty
Diellin dua t'ua fik
Netëve të zhytura në vetmi
Nuk kam fuqi t'iu ik
Edhe në lotët që derdh
Fytyra jote shëndrit
E buzët pas cdo ofshame
Emrin tënd psherëtinë*

Si medaljon

*Shoqa të ylberta zbritë nga qielli
Trupin tim sa t'ma mbështjellin
Me Shiqjetën e Dashurisë
Zemrës m'ia vrave pafajësinë
Me rreze të bukura dielli thurre
Një kurorë të rrejshme fati
Hënën e artë saora zbritë
Medaljon për gjoksin tim*

*Ti më premtove dy jetëra
Të më vjedhësh atë të vetmen
Shkëlqimin e lumturisë zbehe
Tash unë dua të braktis jetën
Se në botë tënde ikën vetëm
Portën mbyll prapa vetes
Ti s'ma fal më dashurinë
Ti s'ma jep të paktën vdekjen*

Në kafaz

*Më more bilbil
Nga kopshti I rinisë
Në kafaz më fute
Të më thuash
Këndo*

*Më shkëpute yll
Mes qiellit të jetës
Të gjallë më varrose
T'më thuash në fund
Jeto*

Vargu I mllefit

*Të daltë tymi moj shtëpi
Gëzim t'prita po c'me shkëmbëve
Të ëndërova kopsht përplot lule
Brenda mureve më robërova*

*Unazë moj zingjir I trupit
Nga pesha e shpirtit si s'u këpute
Ma zure diellin ma zbeve hënën
Atë ditë që në gishtin tim u fute*

*Moj pranverë mos ardhsh tjetër
Nga duvak I zi s'mund të t'shijoj
Mos m'pusho më kurrë në dritare
Se është mëkat të të mallkoj*

Ngushëllim

*Në martesën tonë
Të ftohtë si vjeshtë e vonë
Edhe kur thellë ndjej
Se diçka më mungon
Mendja ime prapë
Zemrën e vrarë mashtron
Por zëri I bilbilit
Kot më ngushëllon
Se për dashurinë tonë
Ende nuk është vonë*

Mos

*Kur gjumë në sy
Natën nuk kam
Mos ma merr hënën
Dritën e vetme
Shkëlqimin e diellit
Ti ma more*

*Kur s'kam fuqi
Zemrën ta pajtoj
Mos ma merr lotin
Ngushëllimin e fundit
Vesën e lumturisë
Ti ma vodhe*

*Më lejo edhe këtë natë
Më lejo edhe këtë mëngjes
Një vrushkull lotësh
Të derdh vetëm për ne
Se dashurinë time të vrarë
Po braktis durimi*

Portat e jetës

*Sa pak shijua
Dashurinë bashkë
Gishtërinjtë e trishtuar të ndarjes
Trokasin në portën tonë
Mbërthimit të thonjve të djallit
S'u liruam gjer në largim
Engjëlli roje
Na braktisi përgjithmonë*

*Dhe pas kësaj
Cilën portë ta hapim
Vallë nuk ke frikë*

Nusëri

*Edhe sonte dua të pushoj
Në gjirin tënd Nusëri
Për ndarjen e rrugëve tona
Kupa lotësh do të pimë
Hallall do të të kërktoj
Për vajtimet e pa zë
Thërrmat e zemrës sime
Prapë do t'I bashkoj në një*

*Që nesër do të fluturoj
Me krahët e Shpresës së Mirë
Që të vazhdoj tutje
Një rrugë përgjysmë të lënë
Do të shkel serish
Në botën e braktisur
Por ti Nusëri do mbetesh
Plagë në mes të zemrës*

28 prill '97 Strasburg

Kthim në muzg

Kthim në muzg

*Zemrën lashë
Kujtimin mora
Atë muzg kur u ktheva
Me qepallat e përlotura
Errësirën mallëngjeva*

Sytë e jetës

*Unë e di se çdo fillim ka fundin
Por fundi ynë erdhi shumë shpejt
Unë e di se pas natës vjen agimi
Por drita e tij do të jetë e zbehtë*

*Unë e di se çdonjëri mbi vete
Një barrë të jetës mban
Një sy I buzëqeshur tjetri I përlotur
Në çdo fytyrë njeriu janë*

*Unë e di se dhëmbja është çmim
Për lumturinë që përjeton
Por do të doja edhe ti ta die
Se çdo dashuri ndarja s'kurrorëzon*

Kënga e pikëllimit

*Shkrova notat e këngës sonë
Ajo s'do të këndohet kurrë
Thurra vargjet e poezisë sonë
Tretën lotët e mi gurrë*

*Shpresat e mia koha I vyshku
Dëshirat e mbledhura humbën
Ëndërrova kurorën tonë
Pa e trashëguar ëndërrat u këputën*

*Për dashurinë zgjodhëm ndarjen
Pas mbeti kënga e pikëllimit
Pa numër qava me pënën time
Poezinë tonë thurra dështimin*

Më ndjej

*Më ndjej pse edhe pas ndarjes
Unë prapë zhgrehem në vaj
Ngado që të shkoj
Shpirtin kam tek ti
Më ndjej pse s'pata fuqi
Atë hap të ta fal
Ti nuk ndjeve kurrë
Peshën e lotëve të mi
Se tradhetia dhemb
Oh dhemb e vret
Si nuk e dite kurrë
Se të pata vetëm ty*

*Më kthe në pragun e vjetër
Të lindim fëmijë
Largohu prej saj
Ajo është fatkeqësi
Unë jam vetëm jotja
Mos m'përplas në vetmi
Për një shushunjë
Që po ta thith rininë*

Vetëm edhe një herë

*Kur të zgjohem në mëngjes
Para syve po të të shihja
Jastëku do të mbushej perla
Në vend të lotëve gurrë
Si kur vetëm edhe një herë
Të fleja në krahët e tu
S' do të dëshiroja
Të zgjohem më kurrë*

*Pendohem pse nuk derdhja
Pikëllimin në dashuri
Përse nuk e trazoja
Helmin me mjalë
Pse ashtu të hidhura
I mbaja në gji
Dhe ty të largoja
Gjithnjë e më larg*

*Dhe të urrej pse shikoje
Luginën tonë I heshtur
Nga lotët e mi shi
Tek binin këpurdhat
Petalet e trëndafileve
Tek derdhja me stuhi
E barin përvëloja
Me ofshamat e djegura*

Trëndafili I bardhë

*Vetëm për Ty
Desha pranverën
Trëndafili im I Bardhë
Vetëm për Ty
U dogja nga etja
Larg buzëve të tua mjalt*

*Vetëm për Ty desha jetën
Me kujtimin tënd
Ushqeva zemrën në pritje
Por tani tradhari im
Gjithë çfarë dua është
Një varr për vdekje
Unë do të vdes dije*

*Për dashurinë tonë
Se ajo më kushtoi
Sa njëmijë jetë
Por do të ringjallem
E në shtegtim për ty
Me shekuj do të ec
Mbi këtë jetë të shkrretë*

Porosi

*M'I thuaj se dielli im
Ndizet e shuhet
Vetëm në sytë e tij
M'I thuaj
Aqoma e dëshiroj pranë
Serish dua t'më vi*

*Se toka edhe qielli
Po të rrokullisen
Zemra ime kurrë
S'do të ndryshoj vend
Le t'më përbuz njerëzimi
Bota le t'përmbysset
Vetëm Zoti e Di
Shpirti sa më dhemb*

Mos më pyet

*Cfarë duhet t'më bësh
Që unë të të harroj
Një herë e përgjithmonë
Do të të përgjigjem
Të më marrësh jetën
Se vdekje më e mirë
Për mua s'ekziston*

*Sytë e fikur nga malli
Do të t'thosha t'm'I verbosh
Buzët e djegura pa puthje
Do të t'thosha t'm'I përgjakësh
Zemrën që ma mban në dorë
Do të t'thosha ta ndrydhësh
Trupin që më bren vetmia
Do të t'lusja ta vrasësh*

*Se nëse në jetë s'më do
Në pritje përjetësisht mbes
Do të të zhvarros nga varri
Në krahët e tu do të vdes*

Më kujto

*Nëse erërat e jetës të përplasim
Ylli I Fatit nuk di të të gjej
Le të trokas në portën e zemrës sime
Aty përgjithmonë do të jesh*

*Nëse rrugët e jetës të kthejnë
Në vendet tona të vjetra
Ndalë dhe shikoi gjatë
Kujtimet do të mbesin të freskëta*

*Nëse dikur mbetesh I vetmuar
Era fytyrën ta ledhaton
Më kujto
Ato janë duart e mia
Ai është shpirti që rënkon*

Betohu Dashuri

*Nëse vetmia e gjatë
Dhëmbjen pas teje do ta mund
Era e stuhishme e fatit
Në krahët e tjetrit më përplas
Zemra do ta ndjej
Ajo s'është Dashuria
Por liqji I patundshëm
I jetës mizore*

*Kur duart e tjetrit
Trupin t'më grabisin
Buzët e mia mequr
Do të pëshpërisin
Betohu Dashuri
Se mua ma fale shpirtin
Që zemrën pas kësaj
Në jetë ta mbaj ngushëllimi
Se trupi I përket tokës
E shpirti frymës së shenjt
Që gezon amshimin*

16 maj '97, Dillingen a.d.Donau

Schwoere Dir Liebe

*Während die Lange Einsamkeit
Die Trauer nach dir Besiegt
Und dash Sturmishes Wind des Schiksals
Mich in die Arme eines Anderes stöst
Das Herz Wird es Spüren
Das ist nicht die Liebe
Sondern das
Gesezt
Des Grausames Lebens*

*Wen die Arme des Anderes
Meinen Körper rauben
Meine trockene Lippen
Werden Kraftloss flüstern
Schwöre dir Liebe
Das du mir die Seele schenktest
Das der Trost nach dir
Das Herz in Leben hielt
Den das Körper gehört zu die erde
Und die Seele zu den heiligen geist
welche die Ewigkeit genießt.*

Poezia Betohu Dashuri (Schwoere dir Liebe) eshte publikuar per here te
pare

Ne librin e vitit 2000, "Das Gedicht des Gegenärt", te "Shoqatës së
Gotes" në Frankfurt në Main.

Poashtu, libri Zemra e Di, me titull pune "Nuse pa kurorë, është zgjedhur
për botim nga Shtëpia Botuese "Foque", po në Frankfurt.

Marshi I vdekjes

Kthim I vonuar

*Kjo furtunë e stuhishme
Në kodrinën e jetës
Rrënjësisht treti gjelbërimin
Vdekja loz vallen llahtarshëm
Nga buzët e mia
Uratë pranon mallkëimin*

*Se ai lumë I gjatë lotësh
Që u shtri përgjatë jetës
Nuk e ndaloi rrjedhën
Gjersa u bë një det
E unë notova baba
Krahëthyer drejt teje
Të gjej qetësinë e humbur
Serish në prehërin tënd*

*Se ti nuk erdhe tek unë
Por as s'më prite të vi
Vallë më pak më deshe mua
Se këtë varr të zi*

E mërkurë, 21 maj '97, Strellc I Poshtëm

Vajtim

*Po të t'shifja edhe këtë herë
Pa le të verbohesha
Pas shuarjes së mallit
Po t'me flisje edhe një herë
Zërin tim do të mbyllja
Në heshtjen e varrit*

*Sikur të më jepje
Vetëm një shenjë dëshpërimi
Të betohem do të dergjesha
Në të njëjtin vend
Sikur t'kisha fuqi
Dje një herë të ta kthej frymën
Gur varri do të bëhesha
Fli për trupin tënd*

Si të t'kujtoj

*Hija jote e dendur
Serish më ofroi prehjen
Por nga plaga e dëshpërimit
Pa u ndier qënqe dergjur
Krahët e tu të gjërë
Prore më ishin strehë
S'ma thoshe se thelbi
Të kullonte gjak heshtur*

*Fati I zi kurrë në jetë
Nuk më ledhatoi
Qëkur të mundi edhe ty
Cdo ditë e më I qobshëm
Se nuk të shoh më
Të ngrehur përkrah diellit
As s'mund të t'kujtoj dot
Të përplasur përmortshëm*

Pa krahë

*Ndoshta mbaje mëni
Babai im I mirë
Prandaj me braktise
Pa Lamtumirë
Më le krahëthyer
Pa ty jam e mjerë
Nuk ma zgjate dorën
Qoftë për të fundit herë*

*Ti s'deshe t'më presësh
Të cmallemi bashkë
Mbylle sy përgjithmonë
Kur shpalosa plagën time
Sikur të më prisje
Vetëm edhe pak kohë
Pritjen do të ta shpaguaja
Me Lulen e Jetës sime*

Amanet

*Cdo ditë më rrezet e diellit
Ta puthi dheun baba
Në heshtje lus qiellin
Me shi t'na vajtoj fatin
Amanet iu lë engjëjve
Roje të t'bëjnë mbi gur
Me shkëmbin e shpirtit
Ta shkruaj epitafin*

*Se bota e mashtrimit
Ishte e panjohur për ne
Toka e tradhtisë
Fushë e pashkëlur
Djerrinë
Ti shkoje pranë Zoti
Të gjesh të vërtetën
Unë në botën e djallit
Do t'mundohem gjithë jetën
Ta kthej bekimin tënd*

2 shtator '97

Krahëthyer

Shtegtim

*Botën mora në sy
Të ik nga ti dhëmbje
Për trupin e lodhur
Të gjej dhe një rini
Por ti më ndoqe pas
Dhe më zure në hap
Me fytyrë tjetër
Por me armë të njëjtë
Se ti u mësove
Mu në thelb të zemrës
T' ma ngulësh shtizën
Vec të shesësh trimëri*

*Në mua thonjtë e përgjakur
Me vite katrithe
Si gjarpër gjaku
Ujin e jetës ma thithe
Zemrën ma përvëlove
Trupin e njomë ma dogje
Por shpirti im I mbryjtur
E I gatuar në lotë
Duron e nuk plas dot*

Unë nuk të njoha

*E vogël ishte
Bota që na ndante
Mbi bjeshkët
Që shtriheshin përgjatë
Kalova si në një oborr tjetër
Edhe për një hap
Në atë udhë
Për një urë
Mes botërave tona
Dhe një gur
Në kështjellën e vjetër*

*Por buzët më folën
Me gjuhën e djallit
Nga sytë shkrepëtiu
Egërsia e bishës
Trupi yt I njomë
U shndërrua në gur
Ishin po ata sy
Që ndër të gjithë I zgjodha
Po ai trup
Që m'rrëfeu c'është dashuria
Edhe ato buzë
Që m'puthën dikur*

Por unë s'të njoha më

Hipokrizi

*Po ta dinit edhe ju
Sa keq të lidh gjuhën
Nyje e fatit mashtrues
Ju dorën do t'ua zgjasnit
Kur pikat e gjakut
Nga trupi të pikojnë
Edhe ato si mua
Përdhe nuk do t'i përplasnit*

*Po ta dinit të gjithë
Si lexohet dhëmbja në sy
Kur këpurdhat e dëshpërimit
Në zemër të shpërthejnë
Atë që në lumturi e deshët
E në mjerim e braktisët
Do ta pagëzonit
Me një emër te shenjt*

28 tetor '97

Plagë e gjallë

*Plagë mbi plagë
Baba I mbolla shtatit
Vec të shpërlaj shpirtin
Nga bloza e mëkatit
E përulur e përplasur
Lus vdekjen t'më rrëmbej
Me një varr aty pranë teje
Rininë time dua ta shkëmbej*

*Se drita e jetës
Më është fikur në sy
E gjithë bota ime
Është këthyer në skëterrë
Dritë e shenjt e Zotit
Kot ma ndircon rrugën
Asnjë hap më tutje
S'kam fuqi ta hedh*

*Dua të lirohem
Barrës së rëndë të jetës
Këtë zemër të përgjakur
Përjetë ta palos në dhe
Dyert e shpëtimit
Shpirtit le t'mi hapen
Trupit tim të dërgjur
Pranë teje le t'm, I gjejnë strehë*

M'u dëfto

*Nga kush tjetër përvec teje
Të kërkoj dorën e mëshirës
Pse s'ma kthen serish bekimin
Drita e amshuar shkëlqen matanë
Unë s'ngjitem dot kësaj rrëpire
Më liro të lutem mallkimit*

*Përse nuk më dëftohesh
Nga thellësia jote e ndritur
Përse nuk më ngushëllon o Zot
Duke më folur për pavdekësinë
Përse në këtë botë të egër
Më lejon të zvarritem
Ma shpëto shpirtin e dëlirë
Se trupin ma hodhën si fundërrinë*

Shko

*E tëra ishte kjo
Dashuri lotë e gjak
Ishin sakrificë e kotë
Jam e përbuzur
E harruar
E lënë qyqe në këtë botë*

Mallkim

*Një kohë të gjatë
Sa mjerimi im
Për ty ruajta zemrën
Trëndafile
Erdha e të thashë
Është jotja
Thurr kurorë për dashurinë
E për buze
Për epshet e vona të rinisë*

*Shumë netë mbeta pa gjumë
Të mbledh rrezet e shpirtit
Dritë
Erdha e t'u rrëfeva
Është gjithë cfarë kam
Ndricoje rrugën e ardhmërisë
Me përqeshe
Syhapur u fute në errësi të*

*Derdha lotë
Të luta
E për unjur të përgjërova
Kthehu
Më mbaj fort
Se dielli yt është në duart e mia*

*Më përplase përdhe
Dhe shkoje drejt humnerës*

Nëse unë vdes

*Mallkimi im me shekuj
Do t'rëndoje mbi atë shtëpi
Vajet e mia të gjata
Do të shembin muret
Tjegullat si gjaku im
Do t'përplasen përtpokë
Si lotët e syve të mi
Do të rrokullisen gurët*

*Pesha e tij Shkëmb
Do të mbyll atë derë
Hija ime do të bredh
Edhe mbi atë gërmadhë
Ofshamat do të mbysin këngën
Tupana dasmeje
As vaj fëmije kurrë
S'do të degjohen në atë prag*

*Do të vijë koha kur do t'kuptosh
Vdekja s'është dënim për të gjithë
Rëndë e egër godet jeta
Mëshiron më pak se vrasësi
Në gjirin e varrit
Prore është shpëtimi
Kur troket ora e mallkuar
Të paguajmë borxhin-t'lajmë mëkatin*

10 dhjetor '97

Dikur do t'pendohesh

*Hija e dashurisë sime
Zgjohet në dhomën tonë
Sa herë ti me tjetrën
Shtrihesh në atë shtrat
Por je I verbër ta shohësh
I shurdhër ta dëgjosh
Tek psherëtin heshtur
Sonte e për çdo natë*

*Me kohë do të shohësh
Sa keq verbon epshi
Vaji I fëmijës së palindur
Do të t'I shpoj veshët
Klithma ime e thekshme
Serish do të çaj muret
Pse ma vratë pa arritur
Ta mbaj një herë në prehër*

*Breshërimat e lotëve të mi
Në shpirt do të t'bëhen gur
Do t'mallkosh kush ndan
Ata që bashkon Zoti
Aty ku mbylla nusërinë
Do të qash do t'vajtosh
Por lutjet e përgjërimet
Do t'I bësh kot së koti*

Nga realiteti do të shkundesh

*Si nga një ëndërr e ligë
Nga magjia e zezë
Atë ditë që të kthjellohesh
Duart e saj të venitura
Kur të ndjesh në trup
Do të stepesh, do t'djersitesh
Do të dridhesh, do t'tmerrohesh*

*Aty do ta ndjesh
Peshën e rëndë të mëkatit
Dhe do të shohësh
Në atë plakë një shtrigë
Do t'pendohesh pse zhbive
Bimën e dashurisë sonë
Për një nepërprkë që t'pjell
Bolla e gjarprinj*

Epilog

Krenaria e Kobi yt

*Unë isha
E fejuara e martuara
Vasha nusja
Virgjëresha e gruaja
Unë isha
E dashuruara e tradhtuara
Nënë prehërbrazët
Me foshnje të gjymtuar*

*Unë isha
Njëmijë femra në një
U murosa hije në atë prag
Bekim e mallkim
Për nderin e njollosur
Për zemrën tënde të plasur
Unë
Krenaria e Kobi yt*

Strasbourg - Strelc - Dillingen
(1995 - 1997)

Redaktor: **Zejnullah HALILI**
Recenzues: **Rifat KUKAJ, Sabit JAHA**
Ilustrimet: **Ajete Sh. Beqiraj**

Shtepia Botuese:

ILIRIKU

Prishtinë, 2000